



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM

Nr. 8, datë 16.03.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE HETIMORE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 14 dhe nenit 27 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, dhe nenit 80 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

- 1.** Të nisë procedurën hetimore për marrjen e masave administrative për kundërvajtjen administrative "Ushtrimi i veprimtarisë pa licence", ndaj operatorve:
 - a.** Shoqëria "Ujësjiellës-Kanalizime Kukës" sh.a;
 - b.** Shoqëria "Ujësjiellës-Kanalizime Fushë Arrëz" sh.a;
 - c.** Shoqëria "Ujësjiellës Has" sh.a;
- 2.** Shoqëritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi të njoftohen dhe të thirren për t'u dëgjuar mbi objektin e procedimit, sipas grafikut bashkëlidhur;
- 3.** Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve me Publikun;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne fletoren zyrtare.

**KRYETARI
Avni Dervishi**